



Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 10 maj 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit të Dorëzimit
të Përgjigjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave
Materiale (F02279)**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21(4)(c) dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 9(5)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 1 maj 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dorëzoi kërkesën për ndryshimin e listës së provave materiale ("Kërkesa e ZPS-së"), ku kërkonte autorizim që të përfshinte materiale në lidhje me, ndër të tjera, dëshmitarë që ZPS-ja synon t'i thërrasë për të dëshmuar midis qershorit dhe korrikut 2024 ("ndryshimet e kërkuara").¹
2. Më 6 maj 2024, ekipet e Mbrojtjes së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (së bashku, "Mbrojtja" dhe "të akuzuarit") dorëzuan një kërkesë të përbashkët për zgjatje të afatit të dorëzimit të përgjigjes ndaj Kërkesës së ZPS-së ("Kërkesa e Mbrojtjes").²
3. Më 8 maj 2024, ZPS-ja dorëzoi një përgjigje ndaj Kërkesës së Mbrojtjes ("Përgjigja").³
4. Më 9 maj 2024, Mbrojtja dorëzoi kundërpërgjigjen e saj ("Kundërpërgjigja").⁴

¹ F02279, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale*, 1 maj 2024, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale.

² F02289, Mbrojtësit e Specializuar, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit të Dorëzimit të Përgjigjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale* (F02279), 6 maj 2024, konfidenciale.

³ F02296, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit* (F02289), 8 maj 2024, konfidenciale.

⁴ F02301, Mbrojtësit e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit* (F02289), 9 maj 2024, konfidenciale.

II. PARASHTRIMET

5. Mbrojtja kërkon zgjatje të afatit për dorëzimin e përgjigjes ndaj Kërkesës së ZPS-së me shtatëmbëdhjetë (17) ditë, deri të enjten, 30 maj 2024.⁵ Mbrojtja parashtron se kërkesa është në kohë dhe se ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e zgjatjes së kërkuar të afatit, sepse pa të Mbrojtja nuk do të ketë kohë dhe burime të mjaftueshme për t'iu përgjigjur Kërkesës së ZPS-së në mënyrë të njëmendtë.⁶ Në veçanti Mbrojtja argumenton se ekzistojnë arsye të vlefshme duke qenë se: (i) Kërkesa e ZPS-së shtron aspekte juridike dhe faktike të reja e të ndërlikuara;⁷ (ii) ndryshimet e kërkuara kanë lidhje me prova që do të përdoren me dëshmitarë dëshmia e të cilëve pritet të ndodhë shpejt dhe është thelbësore për paraqitjen e provave nga ZPS-ja;⁸ dhe (iii) ndryshimet e kërkuara përbëjnë mbi 1000 faqe që kërkojnë kohë dhe burime, ndërkohë që do të thirren për të dëshmuar edhe dëshmitarë të tjerë të rëndësishëm.⁹

6. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja nuk paraqet arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit dhe se zgjatimi i kërkuar prej shtatëmbëdhjetë (17) ditësh është i tepërt, i paarsyeshëm dhe rrezikon t'i shkaktojë vonesë dhe ndërprerje të panevojshme kalendarit të seancave të gjykatës dhe sigurisë së dëshmitarëve.¹⁰ Në veçanti, ZPS-ja argumenton se: (i) Mbrojtja ishte njoftuar paraprakisht në kohë të mjaftueshme në lidhje me materialet në ndryshimet e kërkuara dhe dëshmitarët përkatës;¹¹ (ii) pretendimi për domosdoshmërinë e rishikimit të transkripteve dhe përkthimeve të ZPS-së është i pabazuar;¹² (iii) aspektet e ngritura në Kërkesën e ZPS-së nuk janë të reja;¹³ dhe (iv) Mbrojtja ka pasur dhe do të ketë mundësi të

⁵ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 1, 14.

⁶ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 2, 5-6, 12.

⁷ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 7.

⁸ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 8.

⁹ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 10-12.

¹⁰ Përgjigjja, para. 1-2, 4, 5, 8.

¹¹ Përgjigjja, para. 3(a)-(c).

¹² Përgjigjja, para. 3(d).

¹³ Përgjigjja, para. 3(e).

mjaftueshme për t'u përgjigjur dhe për t'u përgatitur për dëshmitë e dëshmitarëve.¹⁴

7. Mbrojtja kundërpërgjigjet se Mbrojtjes i duhet miratuar zgjatja e afatit në mënyrë që t'i jepet koha e nevojshme për t'u përgatitur, duke qenë se Kërkesa e ZPS-së ndryshon thelbësisht nga të gjitha ato që janë marrë në shqyrtim nga Trupi Gjykses në të shkuarën dhe ngre probleme të trajtimit të drejtë dhe pa shkaktuar dëm.¹⁵ Mbrojtja argumenton se, në këto rrethana, ajo duhet të gëzojë të drejtën e prezumimit të veprimit me ndershmëri dhe trajtimit me respektin e duhur kur kërkon zgjatje afati.¹⁶ Gjithashtu, Mbrojtja kundërpërgjigjet se ZPS-ja nuk arrin të shpjegojë se si miratimi i kërkesës për zgjatje afati do të ndikonte mbi sigurinë e dëshmitarëve dhe integritetin e procesit.¹⁷ Së fundi, Mbrojtja ngre argumente në lidhje me kohën e paraqitjes së Kërkesës së ZPS-së dhe planifikimin e kalendarit të nxjerrjes së materialeve përkatëse dhe radhën e paraqitjes së dëshmitarëve.¹⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Sipas rregullës 9(5)(a), Trupi Gjykses mund të zgjasë *proprio motu*, ose pasi t'i jenë paraqitur arsye të vlefshme, afatet e parashikuara nga Rregullorja ose të vendosura nga Trupi Gjykses.

IV. DISKUTIM

9. Trupi Gjykses konstaton se Kërkesa e Mbrojtjes është në kohë sepse është dorëzuar në kohë të mjaftueshme përpara afatit përkatës.

10. Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja ka paraqitur arsye të vlefshme për një

¹⁴ Përgjigjja, para. 4.

¹⁵ Kundërpërgjigjja, para. 2, 10.

¹⁶ Kundërpërgjigjja, para. 9.

¹⁷ Kundërpërgjigjja, para. 7.

¹⁸ Kundërpërgjigjja, para. 3-6, 10.

zgjatje kohe të kufizuar, duke marrë veçanërisht në konsideratë: (i) rëndësinë dhe sasinë e materialit që ka të bëjë me ndryshimet e kërkuara; (ii) rëndësinë e dëshmitarëve përkatës; dhe (iii) ngarkesën e madhe që kërkojnë edhe përgatitjet për bllokun e tanishëm të dëshmive.

11. Megjithatë, Trupi Gjykses gjykon se zgjatimi i afatit prej shtatëmbëdhjetë (17) ditësh i kërkuar nga Mbrojtja është i paarsyeshëm dhe i tepruar në këto rrethana. Në veçanti Trupi Gjykses vë në dukje se: (i) kërkesa për ndryshimin e listës së provave materiale nuk është kërkesë që materialet e përfshira në ndryshimet e kërkuara të pranohen si prova, por ka të bëjë thjesht me konstatime *prima facie* për relevancën, gjë që nuk kërkon vlerësim të menjëhershëm dhe në shkallë të gjerë të përmbajtjes të këtyre materialeve; (ii) në qoftë se Kërkesa e ZPS-së miratohet, Mbrojtja përsëri do të ketë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për dëshmitë e dëshmitarëve përkatës dhe do të jetë në gjendje rishikojë si duhet materialin në fjalë; dhe (iii) ndryshimet e kërkuara kanë lidhje me dëshmitarë që janë planifikuar të dëshmojnë shumë shpejt. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se, në këto rrethana, për të siguruar efikasitetin dhe kryerjen e shpejtë të procesit dhe për t'u dhënë të akuzuarve kohë dhe mjete të mjaftueshme për t'u përgatitur, një zgjatje më e shkurtër e afatit prej dy (2) ditësh, deri të premten, 15 maj 2024, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme.

12. Trupi Gjykses gjykon se argumentet e tjera të Mbrojtjes nuk janë relevante në marrjen e vendimit për këtë kërkesë dhe, rrjedhimisht, nuk do të trajtohen.

13. Së fundi, në lidhje me kërkesën e ZPS-së që, në qoftë se miratohet zgjatja e afatit, atëherë duhet të zbatohet një qasje graduale, Trupi Gjykses gjykon se një zgjatje e vogël e afatit prej dy(2) ditësh nuk do ta çrregullonte në mënyrë të papranueshme kalendarin e seancave gjyqësore dhe, rrjedhimisht, e hedh poshtë kërkesën e ZPS-së për qasje graduale.

14. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses zgjat afatin që i duhet Mbrojtjes për t'iu përgjigjur kërkesës së ZPS-së deri **të mërkurën, 15 maj 2024.**

V. KLASIFIKIMI

15. Trupi Gjykses vëren argumentet e palëve në lidhje me klasifikimin konfidencial të parashtrimeve të tyre të protokolluara.¹⁹ Trupi Gjykses gjykon se është e mundur të paraqiten versionet e redaktuara publike të Kërkesës së Mbrojtjes, Përgjigjes dhe Kundërpërgjigjes. Rrjedhimisht, për të siguruar zbatimin në masën më të madhe të mundshme të parimit të procesit publik, Trupi Gjykses urdhëron palët të dorëzojnë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre të protokolluara deri **të premten, 17 maj 2024.**

VI. VENDIM

16. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën e Mbrojtjes, pjesërisht;
- b) **ZGJAT** afatin që i duhet Mbrojtjes për t'iu përgjigjur Kërkesës së ZPS-së deri **të mërkurën, 15 maj 2024;** dhe
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen dhe ZPS-në të dorëzojnë versione të redaktuara publike të parashtrimeve të tyre të protokolluara deri **të premten,**

¹⁹ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 13; Përgjigja e ZPS-së, para. 7, që i referohet Kërkesës së ZPS-së, para. 11.

17 maj 2024.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 10 maj 2024

Në Hagë, Holandë.